



4-th International Conference

Albanian Economy: Performance
and Policy Challenges

Saranda, September 11 - 12, 2003

Sistemi i Pagesave


SA PËRDOREN INSTRUMENTET JOCASH NË SHQIPËRI?

Çeku dhe urdhërpagesa janë instrumente pagese që i ofrojnë të gjitha bankat e nivelit të dytë në Shqipëri. Ato janë edhe instrumentet më të përdorura nga klientela. Në mënyrë të veçantë, urdhërpagesa (ose transfera) është më masive se çeku, pasi, përmban më pak rreziqe dhe ka afate më të shpejta përfundimi.

Afatet e përfundimit të një pagese nga urdhëruesi tek përfituesi variojnë nga: në të njëjtën ditë, kur pagesa është brenda bankës, në 3-4 ditë kur pagesa është midis dy bankave të ndryshme¹.

Instrumentet e tjera *jocash* si pagesa periodike e debitimi direkt, ofrohen nga pothuaj të gjitha bankat në Shqipëri, por, në disa banka kanë përdorim më të madh, si Banka Italo-Shqiptare, Banka Fefad, Banka Tregtare e Greqisë etj.

Vlera e pagesave ndërbankare (në mld. lekë).



CILAT BANKA OFROJNË INSTRUMENTE ELEKTRONIKE?

Karta krediti, Visa e Mastercard/Eurocard ofrojnë Banka Tirana, Banka Alpha, Banka e Kursimeve dhe Banka e Parë e Investimeve.

Ndërsa Banka Alpha, Banka Italo Shqiptare e Banka Fefad ofrojnë *karta debiti* dhe përdorim të ATM-ve lokale, pranë sporteleve të tyre.

Banka Amerikane e Shqipërisë është e vetmja bankë në Shqipëri e cila ofron shërbimin *Homebanking* (internetbanking) për klientët e saj.

¹ Bën përjashtim, vetëm Banka e Kursimeve, në disa degë të largëta të saj.

Ç'POZICION ZË BANKA E SHQIPËRISË NË SISTEMIN SHQIPTAR TË PAGESAVE?

Banka e Shqipërisë ka si detyrë të përcaktuar nga ligji 'Për Bankën e Shqipërisë', nxitjen dhe mbështetjen e sistemit të pagesave. Prej kësaj, buron jo vetëm roli operacional e mbikëqyrës që Banka e Shqipërisë ka mbi sistemin shqiptar të pagesave, por edhe ai reformator e zhvillues i këtij sistemi.

BANKA E SHQIPËRISË OFRON SHËRBIMIN E PAGESAVE PËR BANKAT E NIVELIT TË DYTË.

Banka e Shqipërisë është një **ndërmjetëse** aktive në 'klerimin' dhe 'shlyerjen' e pagesave ndërbankare (kujtoni skemat e përshkruara më sipër). Ajo e luan këtë rol, pasi ajo mban llogari në lekë për të gjitha bankat e nivelit të dytë në Shqipëri. Kështu, ajo mund të shlyejë me lehtësi transaksionet e pagesave, duke debituar llogarinë e bankës që urdhëron pagesën dhe duke kredituar llogarinë e bankës që e përfiton atë. Për më tepër, Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore, nuk ka probleme likuiditeti (mospasja e fondeve të mjaftueshme për të shlyer pagesat) apo probleme krediti, kështu që, pagesat e kryera në llogaritë në Bankën e Shqipërisë nuk përmbajnë rrezik mosshlyerje apo rrezik dështimi.

Banka e Shqipërisë u ofron shërbime pagese, bankave të nivelit të dytë. Përveç shërbimeve të *cash-it*, (furnizimi, shpërndarja, grumbullimi e seleksionimi i monedhave dhe kartëmonedhave) ajo ofron shërbime *jocash-i* siç janë: klerimi i çeqeve dhe i urdhërpagesave ndërbankare, shërbimet e shlyerjes neto, përpunimi i pagesave me vlerë të madhe dhe shlyerja e tyre në llogari.

Por, Banka e Shqipërisë është edhe vetë **pjesëmarrëse** e sistemit të pagesave. Ajo kryen nëpërmjet sistemit të pagesave, pagesa për qëllime të politikës monetare. Për më tepër, Banka e Shqipërisë kryen pagesa për llogari të klientëve të saj e pikërisht, një klient mjaft i rëndësishëm, siç është Qeveria Shqiptare.

BANKA E SHQIPËRISË MBIKËQYR SISTEMIN SHQIPTAR TË PAGESAVE.

Ligji i jep asaj të drejtë të përcaktojë **kuadrin rregullativ** të sistemit, duke miratuar rregulla e procedura që janë të detyrueshme të zbatohen nga të gjithë pjesëmarrësit në sistem.


Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë është autoriteti që **mbikëqyr dhe licencon** instiucionet pjesëmarrëse në sistemin e pagesave, bankat e nivelit të dytë që emetojnë dhe ekzekutojnë instrumente pagese. Ajo, jo vetëm mbikëqyr veprimtarinë e këtyre pjesëmarrësve në fushën e pagesave, por edhe **koordinon** punën e tyre. Për të bashkërenduar punën e të gjithë pjesëmarrësve në sistem, Banka e Shqipërisë ka krijuar një forum ndërbankar të përherëshëm, Komitetin Kombëtar të Pagesave, i cili miraton marrëveshje ndërbankare që kanë për qëllim mirëfunksionimin e sistemit të pagesave në Shqipëri.

BANKA E SHQIPËRISË DREJTON REFORMAT PËR MODERNIZIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE NË SHQIPËRI.

Për t'iu përgjigjur detyrimit të saj ligjor për nxitjen e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë ka marrë përsipër rolin udhëheqës për reformimin e sistemit shqiptar të pagesave. Ajo po implementon një sistem bashkëkohor për automatizimin e përpunimit dhe të rrjedhjes së pagesave: **Sistemi RTGS** (Real-Time Gross Settlement).

Ky sistem përpunon pagesat, që ne i quajtmë 'me shumicë', pra, pagesat me vlerë të madhe. Siç e thamë më lart, këto pagesa lindin nga transaksionet e tregjeve financiare, midis bankave apo institucioneve tregtare e qeveritare.

Sistemi RTGS siguron klerimin dhe shlyerjen në kohë reale të pagesave dhe kjo mund të shpjegohet me skemën e mëposhtme:



Banka A duhet t'i paguajë një shumë të caktuar lekësh Bankës B. Për këtë ajo dërgon në sistemin RTGS një urdhër për pagesë për bankën B (hapi 1). Sistemi, në mënyrë automatike, kontrollon llogarinë e Bankës A në Bankën e Shqipërisë (hapi 2) dhe, në rast se ajo ka gjendje të mjaftueshme, bën shlyerjen e pagesës (hapi 3). Pra, sistemi automatikisht debiton llogarinë e Bankës A dhe krediton llogarinë e bankës B dhe, në të njëjtën kohë i dërgon instruksionin elektronik të pagesës, Bankës B (hapi 4).

Ky sistem, duke qenë plotësisht i automatizuar, e përfundon përpunimin dhe shlyerjen e pagesës në një kohë mjaft të shkurtër (brenda një minute). Në qoftë se do të kujtojmë diskutimin tonë për rrezikun, më lart thamë që, një nga mënyrat për eliminimin e rrezikut është reduktimi i kohës midis klerimit dhe shlyerjes. Sistemi RTGS, këtë kohë e redukton pothuaj në zero dhe kështu, sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe çlirohet nga ekzistenca e rreziqeve potenciale të mosshlyerjes.

Banka e Shqipërisë, me vënien në funksionim të këtij sistemi eficient dhe të sigurtë për transferimin e vlerave, i sjell përfitime të rëndësishme sistemit financiar shqiptar, jo vetëm për përmbushjen e nevojave aktuale, por i çel rrugën integritimit të tij në strukturat europiane.